

Njoftim aplikimi për rinovim licence

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për rinovim e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e datës 27.10.2025, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e kësaj licencime.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për licencim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 28.10.2025 deri më 06.11.2025) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.